



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.11.2020, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ramazan Gjuzi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

- Miratimi i procesverbalit të datës 30 tetor 2020.

1. Seancë dëgjimore me aktorët e interesit për diskutimin nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”.

2. Diskutimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”.

Marrin pjesë:

Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Bujar Çela, Fatjona Dhimitri, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Erion Piciri, Amra Barova, Selami Jenishehri.

Mungon:

Enada Kapllani.

Të ftuar:

Isa Rekaj – kryetar i Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë,

Nevrus Kaptelli – kryetari i Sindikatës së Pavarur të Arsimitarëve,

Sandër Kovaçi – kryetar i Sindikatës së Punonjësve të Universiteteve të Shqipërisë,

Altea Lula – drejtore Ekzekutive e Qendrës “Për Arsim Cilësor”,

Gentian Opre – drejtor i Analizës dhe i Programimit Buxhetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

HAPET MBLEDHJA

Ramazan Gjuzi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Ashtu siç jeni njoftuar nga sekretaria, sot në rendin e ditës kemi, së pari, miratimin e procesverbalit të datës 30 tetor 2020; së dyti, seancë dëgjimore me aktorët e interesit për diskutimin nen për nen të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”.

Të ftuar në mbledhjen e komisionit kemi nga Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë, kryetarin Isa Rekaç.

Përshëndetje, zoti Rekaç! Mirë se keni ardhur!

Nga Sindikata e Pavarur e Arsimitarëve kemi kryetarin, zotin Nevrus Kaptelli; nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë kemi zotin Kol Nikollaj, president. Përshëndetje, zoti Nikolla! Nuk paska ardhur.

Nga Sindikata e Punonjësve Universiteteve të Shqipërisë kemi profesorin e asociuar, zotin Sandër Kovaçi, kryetar. Përshëndetje, zoti Kovaçi!

Nga Qendra për Arsim Cilësor kemi zonjën Altea Lula, drejtore Ekzekutive. Përshëndetje! Mirë se keni ardhur!

Së treti, kemi diskutimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”.

Përpara se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, verifikojmë kuorumin e anëtarëve të komisionit.

Mirela Kumbaro?

Mirela Kumbaro – Prezente.

Ramazan Gjuzi – Fidel Ylli? Prezent.

Musa Ulqini? Prezent.

Vilma Bello? Prezent.

Ismet Beqiraj? Prezent.

Fadil Nasufi?

Fadil Nasufi – Prezent.

Ramazan Gjuzi – Adelina Rista? Prezente.

Bujar Çela? Prezent.

Almira Xhembulla?

Almira Xhembulla – Prezente.

Ramazan Gjuzi – Lindita Nikolla? Prezent.

Enada Kapllani?

Fatjona Dhimitri?

Fatjona Dhimitri – Prezente.

Ramazan Gjuzi – Klajdi Qama? Present.

Kostaq Papa? Present.

Selami Jenishehri? Present.

Amra Barova?

Amra Barova –Prezente.

Ramazan Gjuzi – Erion Piciri? Present.

Atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Kush është dakord për miratimin procesverbalit të datës 30 tetor 2020? Kundër?
Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës: seancë dëgjimore me aktorët e interesit për diskutimin nën për nën të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”.

Urdhëroni, zoti Piciri!

Erion Piciri – Si ka mundësi që në ato relacione, që i firmosni ju, relatorja e buxhetit e përmbyll me ndonjë frazë të thjeshtë se X apo Y ishin kundër, por për korrektësi dhe për ndershmëri politike aty duhet të transmetohen me një apo dy fraza edhe konceptet bazike pse ishim kundër këtij buxheti të shtetit! Kundër ishim unë dhe zonja Dhimitri. E lexova relacionin që ishte firmosur nga ju dhe nga zonja Nikolla, por nuk mund të mbyllet me një frazë që ishim kundër, sepse del jashtë kontekstit dhe nuk u shpjegojmë njerëzve. Esenca e komunikimit politik është të paraqitësh edhe idetë. Të paktën me një apo dy fraza të thuhej pse ne ishim kundër buxhetit të qeverisë në lidhje me arsimin.

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Piciri!

Transmetimi është direkt dhe të gjithë njerëzit e dëgjojnë. Megjithatë, do ta bisedoj me këshilltarin, relatorët dhe nënkryetaren dhe do të dalim me një konkluzion.

Erion Piciri – Esenca e kësaj bote, zoti kryetar, është çfarë është e shkruar, sepse fjalët i merr era dhe e shkruara ngelet. Prandaj, në qoftë se ne transmetojmë një qëndrim...

Ramazan Gjuzi – Ato janë në procesverbal dhe do ta shikojmë në të ardhmen.

Erion Piciri – Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit juve!

Atëherë, do t'i dëgjojmë me radhë drejtuesit e sindikatave dhe të Qendrës për Arsimin Cilësor, të cilët besoj se do të shprehen në mënyrë të përmbledhur, pasi i kanë dërguar materialet e tyre me shkrim, të cilat deputetët i kanë në dispozicion. Më pas, fjalën e ka fjalën zonja Nikolla, relatore e projektligjit "Për buxhetin e vitin 2021" dhe pyetjet nga deputetët.

Atëherë, fillojmë me Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë.

Fjala për ju, zoti Rekaj. Përshëndetje! Mirë se keni ardhur!

Isa Rekaj – Përshëndetje!

Federata e Sindikatave të Arsimit e ka parë me kujdes buxhetin e vitit 2021. Ne e njohim situatën dhe e quajmë një buxhet të një kohe krize, megjithatë, nga verifikimi dhe nga studimi që kemi bërë, duket se ka mjaft optimizëm nga hartuesit e këtij buxheti. Ne e vlerësojmë optimizmin dhe urojmë që me këtë frymë të jetë edhe zbatimi konkret i këtij buxheti.

Vlerësojmë rritjen e pagave të mësuesve me 15%, siç është vendosur edhe në buxhetin e ri 2021. Nënvizojmë se përsëri vazhdon të mbetet e ulët përqindja e buxhetit për arsimin. Krahasuar me prodhimin e brendshëm bruto, ai vazhdon të ngelet aty ku ishte, pothuajse rreth 3%. Ndërkohë që ka një zbritje në raport me buxhetin e përgjithshëm nga viti i kaluar; këtë vit është 7,35%, ndërkohë që vitin e kaluar ishte rreth 8%.

Duke e paraqitur materialin tonë sa më shkurt që të mos harxhojmë kohë kot, ne i sugjerojmë Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, që, meqenëse sistemi arsimor parauniversitar ndodhet në një reformë të thellë, duke filluar që nga viti 2012, ka kaluar në disa faza e tani ndodhet në fazën e katërt, që është edhe faza përmbledhëse, dhe objektivi i qeverisë mbi këtë fazë është integrimi i sistemit arsimor parauniversitar në hapësirat europiane, po të shikojmë ecurinë e procesit mësimor, sidomos kohët e fundit për shkak të situatës së vështirë, mendojmë se është e domosdoshme të kemi disa mjete të reja mësimore për mësimdhënien. Në fakt, këto mjete mësimore janë elementare dhe ne kemi biseduar në kohë, por ato vazhdojnë të mungojnë, por sot nuk mund të kuptohet që në një klasë për mësimdhënie me metodat që kërkon vetë reforma e re arsimore, të mungojë një videoprojektor dhe një laptop. Në përgjithësi kjo mungon në shumicën e klasave... Vetëm pajisja e të gjitha klasave me këto dy mjete të domosdoshme do t'i kushtojë buxhetit të shtetit jo më shumë se 10 milionë euro. Besoj se, për hir të kësaj reforme të thellë dhe meqenëse ndodhemi në fazën përmbledhëse ose përmblyëse, duhet të shtohet në buxhetin për sistem arsimor parauniversitar. Ne nuk po flasim për mjete moderne, pasi e njohim situatën, jemi në kushte krize dhe arsimit ndodhet në vështirësi, por është e domosdoshme që brenda janarit të fillojë pajisja e të gjitha klasave me një videoprojektor dhe *laptop*, të cilat janë elementare për metodat e reja të mësimdhënies.

Problemi i dytë i sistemit arsimor parauniversitar është edhe transporti i mësuesve, gjë që është diskutuar disa herë me Ministrinë e Arsimit, por nuk është zgjidhur. Së pari, ky transport sot, në kushtet e pandemisë, nuk krijon mundësinë e respektimit të protokollit antipandemi dhe, së dyti, vlera e biletës që rimbursion shteti është rreth 30% më e ulët se vlera e çmimit të tregut. Në këto kushte, është shumë shqetësues fakti që mësuesit nuk marrin pagesën reale për transportin, , mjetet e transportit në kushtet e përshtatshme teknike nuk lidhin kontrata me shkollat dhe me drejtoritë e shkollave me këtë çmim që ka bileta që rimbursion shteti. Në këto kushte mësuesit udhëtojnë me mjete të çfarëdoshme, jashtë kushteve teknike, ku kanë ndodhur edhe aksidente deri me pasoja tragjike pikërisht për këto shkaqe, për shkak të mjeteve jo në kushte teknike dhe drejtuesve të paafte dhe të palicencuar për të drejtuar mjetet e transportit publik. Kështu që, vlera e shtesës në buxhet të zëri i transportit për sistemin arsimor parauniversitar është mjaft e ulët, thuajse e papërfillshme, dhe për këtë duhet kujdesi i institucioneve përkatëse.

Ndërkohë, të gjithë e kemi vlerësuar punën e mësuesve në mbylljen e vitit shkollor 2019-2020, sakrificat e mëdha dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të atij viti shumë të vështirë, ndërkohë që akoma më i vështirë është viti shkollor që sapo ka filluar, prandaj ne sugjerojmë që të mos ngelet vetëm në kuadër të fjalëve, por mësuesve t'u ofrohet një shërbim, sado modest, në përmbyllje të vitit kalendarik. Në qoftë se ky shpërblim do të ishte në vlerë 10 mijë lekë, ose ndryshe 100 mijë lekë të vjetër, shumën e këtij shpërblimi nuk arrin as 3 milionë euro. Për mësuesit ky shpërblim ka shumë rëndësi, sepse, përveç lodhjes dhe kontributit të madh, mësuesit gjatë periudhës së pandemisë kanë shpenzuar për mjetet e mësimdhënies në distancë dhe për pajisjen e plotë me internet në kushtet e shtëpisë.

Të gjitha këto së bashku nuk kërkojnë më shumë se 15 milionë euro, që besoj se nuk duhet t'ia adresojmë sistemit arsimor parauniversitar në këto kushte të vështira.

Së fundi, unë dua të bëj një thirrje të domosdoshme, në emër të mësuesve, për respektimin e protokollit anti-COVID. Të gjitha strukturat shtetërore, në veçanti pushteti qendror dhe lokal, gjatë procesit arsimor duhet të ndjekin me kujdes dhe të ndjekin me përpikëri kodin antipandemi, sepse po neglizhohet. Në qoftë se njeri prej aktorëve neglizhon, atëherë, ne do të detyrohemi të kthehemi aty ku ishim, dhe kjo do të ishte një goditje e rëndë për arsimin, për nxënësit dhe për të ardhmen e tyre, e cila është e ardhmja e Shqipërisë.

Zoti kryetar, ju falënderoj!

Ramazan Gjuzi - Faleminderit, zoti Reka!

Fjalën e ka përfaqësuesi i Sindikatës së Pavarur të Arsimitarëve, kryetari i saj, zotit Nevruz Kaptelli. Përshëndetje, zoti Kaptelli! Fjala për ju.

Nevruz Kaptelli - Përshëndetje!

Ju falënderoj për ftesën!

Të nderuar deputetë!

Falënderojmë Komisionin e Edukimit, sepse, si çdo vit, edhe këtë vit është i interesuar për të dëgjuar mendimin e përfaqësuesve dhe të mësuesve, do të donim që ky veprim të bëhej edhe nga Ministria e Arsimit, pasi në periudhën kur ministre ishte zonja Nikolla në vitin e fundit dhe ministrja, zonja Besa Shahini, u morën parasysh një pjesë e mendimeve tona për buxhetin e arsimit, por këtë vit ne nuk u thirrëm fare nga Ministria e Arsimit dhe kjo është e pafalshme. Dua t'i kujtoj ministres së re, të cilën e kam përshëndetur për përzgjedhjen e saj në atë post, që buxheti i arsimit është buxheti i taksapaguesve shqiptarë dhe pjesa më e interesuar për këtë janë partnerët socialë, siç jemi ne, sindikatat e arsimit, të cilat nuk u thirrën fare për të dhënë mendimet atje ku duheshin. Ne këtu mund të diskutojmë dhe kemi diskutuar çdo vit, kemi marrë mbështetjen e një pjese të deputetëve, por asnjëherë kërkesat tona nuk kanë gjetur mbështetje në buxhet.

Edhe ne, edhe sindikata tjetër, kryetari që sapo foli, që në fillim kemi kërkuar ato që ishin premtuar për arsimin që në fillim të mandatit të dytë qeverisës. Ne kemi kërkuar 5% të GDP-së, si buxhet për arsimin dhe, për fat të keq, kanë kaluar 7 vjet dhe ne ndodhemi përsëri, aty ku tha parafolësi, në 3% të GDP-së për arsimin, gjë e cila bën të pamundur plotësimin e nevojave të ngutshme që ka sistemi arsimor në Shqipëri për një mësimdhënie cilësore dhe për rritjen e nivelit të arsimit në përgjithësi. Megjithatë, unë dua të ndalem te disa probleme të tjera, që ju i keni përpara, pasi i kemi dërguar me shkrim.

Problemi i parë janë pagat e mësuesve. Më vjen mirë që përballë kam edhe ish-ministren, zonjën Nikolla, ku i kujtoj që disa herë bashkë me Kryeministrin dolën në fillim të mandatit dhe premtuan që gjatë këtij mandati të dytë 4-vjecar do të rrisin pagat e arsimit në masën 40%. Ne, të dyja sindikatat, në aleancë me njëra-tjetrën, e pranuan këtë rritje dhe nuk kishim ndonjë pretendim më të madh, duke parë edhe kushtet në të cilat ndodhemi, edhe mundësitë financiare, në të cilat ndodhet vendi. Ne kishim një vërejtje, që ky 40%, për të cilin binim dakord, të jepej proporcionalisht, pra rritja e pagës të bëhej çdo vit 10%, por, për fat të keq, kjo rritje nuk u bë dhe u bë ajo, të cilën e parashikonin gazetarët dhe ne, që kjo rritje është premtuar tani, në prag të zgjedhjeve të tjera. Më e keqja e kësaj është se ne nuk kemi marrë të njëjtin vlerësim me mjekët dhe infermierët, pasi atyre do t'u rritet paga 40%, ashtu siç është premtuar, ndërsa ne do të na rritet vetëm 15%. Kjo rritje 15% nuk është rritje e pagës që marrin sot arsimtarët, por është 15 e pagës së pozicionit që marrin arsimtarët. Kjo do të thotë që pjesa më e madhe e kësaj mbulon inflacionin prej 2,4 %, i cili rritet sipas statistikave të INSTAT-it.

Për herë të parë ne shohim që në këtë buxhet edhe inflacioni është parashikuar 1% për vitin 2021, por nuk shohim që të ketë një zë të veçantë për mbulimin e inflacionit me buxhetin që parashikohet. Pra, kjo rritje e pagave është e papranueshme për ne, si përfaqësues të mësuesve, meqenëse paga nuk u rrit me 10% çdo vit dhe ju jeni në mandatin e dytë qeverisë, ne prisnim që kjo rritje të kishte shkuar 40%. Megjithatë, përveç kësaj, unë do të thosha atë që përmenda pak më parë, kjo nuk është një rritje reale dhe, po ta shikoni, kjo i ka bërë të pakënaqur të gjithë mësuesit, të cilët na drejtohen duke na thënë se si mund ta pranojmë ne si sindikata këtë rritje, kur nga vetë qeveria u ishte premtuar 40%.

Një problem tjetër është transporti i mësuesve. Buxheti për transportin e mësuesve, ashtu siç e përmendi edhe kolegu ynë, është i pamjaftueshëm, sidomos në kushtet e pandemisë. Në qoftë se do të zbatohet udhëzimi i Ministrisë së Arsimit dhe të gjitha protokollat e Ministrisë së Shëndetësisë, për një transport në përputhje me protokollin ky buxhet është i pamjaftueshëm. Këtu nuk ka ndryshuar asgjë, përveç faktit që mësuesit duhet të lëvizin dhe të shkojnë në qendrat e tyre të punës, ata që e kanë larg vendbanimit të tyre me të njëjtat mjete transporti, të cilat rrezikojnë qëndrimin e tyre. Nëse do të vini re, çdo ditë numri i mësuesve që infektohen me virusin COVID-19 është gjithnjë e në rritje. Po t'i shtosh kësaj edhe të gjitha mungesat që vijnë si rezultat i mësimit sipas kërkesave të protokollit nga pushteti vendor, kjo jep tamam tablonë që sot njohim për mësuesit. Ne kërkojmë nga Ministria e Arsimit dhe qeveria të nxjerrin një VKM, ku të përcaktohet qartë pagesa e transportit dhe të jetë ashtu, siç është theksuar në buxhet. Po ta lexojmë te buxheti i vitit 2021, aty është shprehur qartë se shteti merr përsipër mbulimin e shpenzimeve të transportit 100% të mësuesve, që janë mbi 5 kilometra larg nga qendra e banimit të tyre dhe të nxënësve që janë mbi 2 kilometra larg nga qendra e banimit të tyre. Kjo duhet të ketë një llogaritje të saktë, sepse ju jeni vetë dëshmitarë, flas për ata deputetë që kanë kontakte me mësuesit në zonat e tyre elektorale, që mësuesit shkojnë në vendet e tyre të punës disa kilometra larg dhe nuk marrin as gjysmën e pagesës së asaj që paguajnë. Më e keqja pastaj është që në VKM ka një nonsens, ku mësuesve nuk iu llogaritet largësia nga vendbanimi, por nga qendra e vendbanimit. Me zyrat vendore arsimore të rrethit që u krijuan, si në zonat e Vaut të Dejës, të Cërrikut, të Belshit, të Selenicës, të Roskovecit dhe shumë zyra të reja arsimore, që u krijuan, nuk iu llogaritet kjo gjë. Pra, ata shkojnë më jo nga qendra e këtyre vendbanimeve që unë përmenda, por nga Shkodra në Vau të Dejës, shkojnë nga Vlora në Selenicë dhe ata duhet të rimbursohen, ashtu siç thuhet në projektbuxhet, 100% për vlerën e transportit që ata shkojnë në vendet e tyre të punës.

Një problem tjetër, që e kemi theksuar çdo vit, ishte edhe dhënia e librave dhe e fletoreve të punës falas. Ne do të dëshironim që në buxhetin e vitit që vjen këto të përfshihen

dhe këtë gjë ne e kemi kërkuar për të gjithë arsimin e detyrueshëm, ashtu si e ka edhe shteti ynë fqinj Maqedonia, por të paktën të parashikohet që të mbulojë të gjitha klasat deri në arsimin e nëntë. Më kryesorja është që në këtë mbulim të shpenzimeve duhet të futen edhe fletoret e punës, sepse në shumë raste me çmimin e tyre abuzohet dhe, po t'i shikoni, në fakt, fletoret e punës në disa raste kanë çmim më të larta se vetë tekstet shkollore.

Një problem tjetër: ne do të donim që të kishte më shumë fonde, e kemi kërkuar edhe vitin e kaluar, sepse fondi ka qenë shumë i ulët dhe nuk zbatohet më asnjë vit, për trajnimin e mësuesve. Në ligjin nr. 69/2012 është e përcaktuar qartë se shteti merr përsipër mbulimin e jo më pak se tri trajnimeve çdo vit të mësuesve. Po t'u referohemi përsëri vendeve të rajonit, edhe Maqedonia, edhe Kosova e kanë buxhetin dhe trajnimet për mësuesit i bëjnë falas, kurse këtu te ne asnjë vit nuk janë marrë masa për trajnimin e mësuesve.

Unë dua të them se ky buxhet është i pamjaftueshëm edhe për pagat, edhe për trajnimet, edhe për transportin dhe më kryesorja është që para 7 vjetëve pagat e mësuesve në vendin tonë ishin më të larta nga të gjitha vendet e rajonit dhe sot ju e keni mundësinë të gjithë për t'i parë. Ne jemi në fund, jemi mbrapa Kosovës, mbrapa Maqedonisë, mbrapa Malit të Zi për pagat e mësuesve. Unë do të doja që ju, meqenëse pjesa më madhe juaja vini direkt nga mësimdhënia, duhet të mendoni më shumë arsimin, sepse si ju, ne dhe ata që drejtojnë arsimin jemi përgjegjës të gjithë së bashku për situatën në të cilën ndodhet arsimi sot. Kjo situatë nuk mund të rregullohet pa një buxhet të mjaftueshëm për një arsim cilësor. Panorama që ne shikojmë çdo ditë tregon se sa pak është bërë për arsimin gjatë këtyre viteve. Këtu nuk ka asgjë për të qeshur, në fakt, por, po të shikoni numrin e nxënësve, do të vini re që çdo vit ka një trend rritës të nxënësve, përveç atyre që largohen në emigracion, që ikin nga arsimi publik dhe shkojnë drejt arsimit privat. Ju lutem, interesohuni dhe shikoni në rrethet tuaja, ky trend i nxënësve që kalojnë nga arsimin publik në arsimin privat është në rritje apo është në zbritje?! Kur kjo të jetë në zbritje, atëherë do të thotë se ne e kemi futur arsimin në rrugën e mbarë, por, përderisa në të gjitha takimet që ne bëjmë të dyja sindikatat, konstatojmë dhe marrim informacione nga drejtuesit tanë të strukturave të rretheve që arsimi privat po merr çdo vit shumë nxënës nga arsimi publik, mbajtja e mësuesve në sistem po bëhet e vështirë dhe duhet të mendojmë të gjithë. Për ta rregulluar këtë gjë rruga e vetme është që të interesohemi të gjithë për të rritur buxhetin e arsimit.

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Kaptelli!

Atëherë, fjala për përfaqësuesin e Sindikatës së Punonjësve të Universitetit të Shqipërisë, profesor i asociuar, doktor Sandër Kovaçi, kryetar i sindikatës.

Përshëndetje dhe mirë se keni ardhur, zoti Sandër!

Fjala për ju.

Ju lutem, hapeni mikrofonin!

Sandër Kovaçi – Përshëndetje!

Ramazan Gjuzi – Përshëndetje!

Mirë se keni ardhur!

Sandër Kovaçi – Në radhë të parë, faleminderit për mundësinë që na dhatë për të dhënë mendimet tona lidhur me projektbuxhetin e vitit 2021! Edhe për ne është jetike diskutimi i këtij projektbuxheti dhe mezi presim të shikojmë se sa mundësi ka Komisioni i Edukimit dhe i Medies që të mund të ndryshojë diçka në këtë fazë, megjithëse nuk e di se sa hapësira ka. Ne vijmë me disa propozime që mendojmë se janë të vlefshme.

Të them të drejtën, në fazën paraprake, para se buxheti të kalonte në votim në tërësi, ne kishim shpresa dhe ishte një opinion në universitet se edhe për pedagogët do të kishte një rritje të pagave deri në 20%. Fakti që ministrja e Arsimit në Komisionin, në mos gabohem, të Ekonomisë, deklaroi se nuk ka rritje asnjë për qind për universitetet, ky është një zhgënjim i madh edhe për kolegët tanë, pasi kishin vërtet pritshmëri.

Unë kam kënaqësi, sepse në këtë komision janë të gjithë njerëz të nderuar, por mbi të gjitha ka edhe njerëz në fushën e arsimit, edhe ish-ministrja, nuk po i përmend të gjithë, por po them profesor Ismeti ka qenë anëtar i kryesisë së sindikatës sonë dhe ishte shumë i vlefshëm për ne dhe për universitetin, prandaj mund të diskutoj hapur për problematikat e universitetit.

Ne i kemi dërguar qeverisë që më datë 17. 05.2019 disa kërkesa, të cilat jua dërguam edhe juve shkurtimisht, shpresoj t'ju kenë ardhur, ku kemi kërkuar që të ketë ndryshime në trajtimin e buxhetit për arsimin e lartë.

Siç rezulton, vetëm 0,6% e prodhimit të brendshëm bruto i kalon arsimin të lartë. Në atë kohë, duke parë edhe situatën emergjente të kërkesave të studentëve, qeveria doli me platformën “Pakti për Universitetin”, që fatkeqësisht u përqendrua vetëm te studentët, sepse ata luftuan më shumë dhe aspak te pedagogët. Unë them se nëse nuk do ta fillojmë nga trajtimi dinjitoz i pedagogëve, me pagesa të arsyeshme, nuk po themi të kemi luks, në mënyrë që pedagogu të jetë në ballë të kërkimit shkencor dhe të një mësimdhënieje dinjitoze, duke mos pasur nevojë të vërtitet këtej e andej që të plotësojë të ardhurat për familjen e vet.

Konkretisht, në atë kohë, ne kemi parë si një emergjencë çështjen e arsimit të lartë, pra të shihet sikur është Covidi sot, në këtë kuptim, të shikohet si një emergjencë kombëtare. Pra, nëse dyfishojmë buxhetin për arsimin e lartë, kjo sigurisht nuk bëhet për një vit, por për një periudhë të caktuar 1, 2 apo 3-vjeçare, atëherë vërtet do të bëhet një kthesë, vetëm atëherë do

të arrijmë të përmirësojmë situatën ekonomike dhe zhvillimin e vendit. Por nëse do të vazhdojmë me këtë nivel, duke bërë sikur po i paguajmë pedagogët, edhe pedagogët bëjnë sikur mësimi jepet mirë, bëjnë sikur kërkimi shkencor jepet mirë, por pa para sigurisht që nuk bëhet dhe në fund rezultatet do të jenë që universiteti do të kthehet në një klasë të 13, pra nuk do të realizohen interesat e shoqërisë. Prandaj kërkua dyfishimin e buxhetit për arsimin e lartë, duke nisur me investime dhe kjo sjell edhe rritjen e pagave të pedagogëve. Megjithatë, që nuk do të kishte asnjë rritje, kjo ishte e paimagjinueshme.

Më e keqja është se këto kërkesa ia kemi nisur zotit Kryeministër, shkëlqesisë së tij dhe zonjës ministre, në atë kohë Besa Shahinit, por akoma nuk kemi asnjë përgjigje. Unë jam jurist dhe nga praktika administrative duhet që brenda 30 ditëve, kur dikush të çon një shkresë zyrtare me firmë, me vulë dhe me protokoll, duhet të japësh një përgjigje, nëse je shtet serioz. Pra, një përgjigje që: po, këto problematika do t'i diskutojmë, do të krijojmë grup pune ose do t'i shikojmë se si do të trajtohen, sepse përderisa dërgohen, këto problematika janë, pra mbron çështjen tënde dhe ne mendimet tona dhe ballafaqohen. Pastaj fazë pas faze mund të zgjidhen çështjet e universitetit për të ecur përpara. Por, ne nuk morëm asnjë përgjigje, por një lloj arrogance do të thosha.

Mirë Kryeministri nuk ktheu përgjigje, por ai ka staf administrativ, sepse nuk i kthen përgjigjen vetë, por mund t'ia japë porosi dikujt atje. Ministria e Arsimit ka të drejtën morale dhe detyrimin moral që të kthejë një përgjigje zyrtare.

E dyta, nëse i marrim ato pika me radhë, ne kërkojmë që të rritet me patjetër paga e pedagogëve dhe e stafit ndihmës administrativ. E thashë edhe një herë: pa një trajtim dinjitoz të pedagogut, të mos presim të kemi një arsim të lartë cilësor, sepse vetëm gënjejmë veten.

Ne kemi kërkuar rritje për pagën e orës suplementare. Megjithëse, tani është vënë në garë ministria me bordin e administrimit që t'ia kalojnë njëri-tjetrit me idenë që mund t'i caktojnë universitetet vetë, pa orët suplementare, por rezulton që orët suplementare paguhet në bazë të udhëzimit të ministrisë. Pra, aty ka edhe udhëzim, pastaj thuhet se keni edhe ju mundësi për t'i rritur. Në fakt udhëzimi është qesharak. Nëse e krahasojmë një orë në një universitet publik të jashtëm, sepse pedagogu paguhet 7 apo 8 mijë lekë, ndërsa asistentin me 6 mijë lekë bashkë me zbritjet që i bëhen, pra, si mund të marrësh një pedagog të jashtëm dhe cilësor? Si mund ta bëjë mësimin sakë, kur ai paguhet 6 mijë lekë të vjetra për një orë 50 minutëshe? Prandaj, ne kemi kërkuar që për të sjellë pedagogë të mirë, t'i afrohet deri diku pagesës së universiteteve private. Ne tani po injorojmë shtetin apo jo, sepse del që shteti është i mbaruar fare dhe paguan pedagogun me 6 mijë lekë orën, ndërsa privatin e paguan me 20 mijë lekë orën. Pra, ka një absurditet, prandaj ngelemi të marrim pedagog të jashtëm sorrogatë

ose ngarkojmë pedagogët e brendshëm me nga 200 – 300 orë më shumë, në mënyrë që të realizohet programi. Pastaj kërkimi shkencor shkon atje ku shkon, sepse pedagogu është i ngarkuar gjithë ditën.

Duhet të dini që realisht gjendja financiare e pedagogeve ka zbritur, pra nuk është rritur por ka zbritur. Përse?

Së pari, si rezultat i rillogaritjes së tatimeve, sepse kanë lëvizur tatimet në burimet dhe ka një zbritje, sado të vogël.

Së dyti, si rezultat i mënyrës së llogaritjes së orës mësimore. Nëse keni durim të më dëgjoni edhe një sekondë, ka një zbritje me 50% të llogaritjes së orës mësimore, si rezultat i mosdiferencimit të orës mësimore të leksionit me atë të seminarit, si dhe të leksionit në master me atë të leksionit në *bachelor*. Për shembull, përpara leksioni në master e kishte koeficientin 2, pra ti jepje një orë kalendarike dhe merrje dy orë mësimore në master shkencor. Edhe kur jepje leksion në baxhelor, kofiqenti ishte 1,5 për leksionin, ndërsa për seminarin e ishte 1. Por sot të gjitha janë bërë 1, si laborator, seminari dhe leksioni. Pra, duket diferencimi që kalon çdo gjë në nivelin minimal, prandaj them që realisht gjendja financiare ka zbritur.

Ne kemi kërkuar që të llogaritet tatimi për orët suplementare. Pra, orët suplementare apo orët shtesë që jepen në një universitet private, por edhe në ato shtetërore, duhet të llogariten me shpërndarje përgjatë vitit. Këtu çfarë ndodh? Meqenëse ato paguhen në fund të vitit, sepse nuk ke pasur mundësi t'i paguash, për këtë paguan edhe interesat, por në pagën e atij muaji, për shembull në dhjetor, futen edhe orët shtesë dhe thotë që ke arritur kuotën 2 milionë lekë. Por ato janë lekët e gjithë vitit. Pra, këtu futet edhe rroga e atij muaji dhe kalohet ajo fasha, prandaj duhet të paguash 23% të tatimit mbi këtë pagë. Pra, ne kërkojmë që të gjejmë një mekanizëm, sepse kjo është një vjedhje e “kamufuar”, pa paragjykim, por Ministria e Financave nuk lëshon pe dhe i bën llogaritë sipas interesit dhe politikës së vet financiare, por kjo bien në kurrizin e pedagogëve. Ne kemi propozuar që orët shtesë, pra suplementare të llogariten si honorar, sepse ajo orë është jashtë rrogës; ajo orë është bërë jashtë mundësive, prandaj duhet të llogaritet si honorar shtesë dhe të paguhet 15% si tatim në burim.

Unë te privati shumicën e kohës shkoj pas orës katër dhe kjo më futet në rrogë. Shteti kur ka bërë diferencimin e rrogës ka thënë: kush e ka pagën më të madhe, paguan më shumë dhe kush e ka pagën më pak paguan më pak, por jo kur unë lodhem më shumë, të paguaj më shumë. “Pagë” quhet ajo që është brenda kalendarit zyrtar, ndërsa ajo që marr unë kur punoj pasdite, nuk duhet të jetë brenda kësaj page. Ajo është një honorar që marr unë për orët shtesë, kur jap një konsultim, apo diçka tjetër, prandaj kemi propozuar që kjo të tatóhet me 15 %, ashtu siç e ka caktuar qeveria. Kështu që mendoj se duhen rregulluar këto, në mënyrë që të mund të

përmirësohet, të paktën në mënyrë indirekte, gjendja financiare e pedagogëve. Meqenëse nuk po ndërhyhet këtu, shpresoj të ndërhyhet edhe në ndonjë zë të buxhetit, të gjendet ndonjë hapësirë për të bërë ndonjë transferim. Mund të futen edhe pedagogët në një fashë 20% rritjeje, të paktën, se nuk e imagjinoj dot si është situata. Ju ndoshta besoni që është vetëm te studentët situata në problematika e të tjera, kanë shqetësimet e tyre, por ta dini se te pedagogët është më shumë. Nuk është asgjë një grevë studentësh, po u bë një grevë pedagogësh, se ajo është bashkë me studentët pastaj. Është shumë e rëndësishme të shprehet vullneti për një mbështetje të pedagogëve.

Unë jam shumë i kënaqur që po flas me një komision të nderuar, ku shumica janë pedagogë e personalitete të shquara. Ndaj mendoj se do ta keni mirësinë apo hapësirën për t'i bërë presion, në kuptimin pozitiv të fjalës, qeverisë që të mund të gjejë mekanizmat, Ministrisë së Financave, për të bërë një transfertë në kuadrin e këtij ligji, derisa të bëhet botimi final që të mund të përmirësohet diçka dhe universitetet të mos dalin pa një përmirësim.

Së fundi, vendosja e shtesave mbi pagë në lidhje me dëmshtëpërblimin e shëndetit në punë. Aty është profesor Ismeti, i cili e di shumë mirë në fushën e tij se sa nevojë kanë laborantët dhe stafi akademik ku punon me laboratorë dhe kanë kontakte me substanca të rrezikshme e preparate të tjera. Ka goxha kufizime. Nuk u janë dhënë në mënyrë të mjaftueshme të gjitha kurbacioneve, të cilat preken nga këto preparate, që të plotësohet në tërësi kjo gjendje. Prandaj edhe këtu kërkojmë, ndoshta, nuk e di, se sa hapësirë ka komisioni për të bërë sugjerime. Por, mbi të gjitha, rëndësi ka që po i shprehim.

Unë shpresoj se këto lloje dëgjësash nuk na shërbejnë as juve, as neve për fasadë. Shpresoj që ju do ta keni mundësinë të mund të ndryshoni, përndryshe bëjmë një vrimë në ujë edhe ne që vijmë, sado ju falënderojmë që na keni ftuar për t'u dëgjuar. Por shpresoj që do të keni edhe mundësinë të mund të ndryshoni diçka, sepse si ligjvënës pa dyshim që keni hapësirat tuaja.

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Kovaçi!

Sandër Kovaçi – Faleminderit juve!

Ramazan Gjuzi – Fjalën e ka përfaqësuesja e Qendrës “Për arsim cilësor”, zonja Altea Lula.

Përshëndetje, zonja Lula!

Altea Lula – Përshëndetje!

Shumë shkurtimisht, edhe për t'iu bashkuar propozimeve që kanë ardhur edhe nga parafolësit për sa i përket shtimit të fondeve për buxhetin e Ministrisë së Arsimit, do të përqendrohesh në atë që është edhe fokusi ynë, që është arsimi parauniversitar.

Pavarësisht buxhetit tejet pozitiv të këtij viti, ndryshe nga vitet e tjera, dhe vlerësimeve për Ministrinë e Arsimit për këtë pozitivitet të treguar, objektivat për arsimin parauniversitar mbeten prapë larg parashikimeve si të programit të qeverisë shqiptare, ashtu edhe ato të Bashkimit Europian. Arsimi parauniversitar do të zërë vetëm 1,55 deri në një maksimum prej 1,79 të PBB-së, pra larg 4%-shit të premtuar nga vetë qeveria shqiptare. Nevoja për shtimin e fondeve është e mbështetur dhe është përforcuar nga vetë kërkesa drejtuar Ministrisë së Financave nga Ministria e Arsimit për shtimin e fondeve për arsimin bazë, atë të mesëm dhe atë të lartë. Kjo ishte për sa i përket buxhetit në përgjithësi.

Në mënyrë më specifike do të përmendja rritjen e financimit për trajnime e të gjithë mësuesve. Shpenzimet që planifikohen për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, janë tepër të ulëta për të dyja programet, si për arsimin bazë, edhe për arsimin e mesëm. Në vitin 2021 parashikohet të shpenzohet vetëm 0,13% e buxhetit të programit për trajnimin e mësuesve në arsimin bazë për kurrikulën e re dhe vetëm 0,2% në arsimin e mesëm.

Po ashtu, në qoftë se do t'i referohemi edhe draftstrategjisë (pra dokumentit të ri politik për arsimin) 2021-2026, evidentohet sërish mungesa e mbështetjes së mjaftueshme të zhvillimit profesional të mësuesve në kuadër të zbatimit të kurrikulës së re, duke u bazuar pra mbi kompetencat. Nevojitet rritje e buxhetit për këtë produkt, pasi vetëm në këtë mënyrë do të kishim monitorimin sistematik të procesit dhe vlerësimin real të nevojave që mësuesit kanë në evoluim.

Një tjetër aspekt përsëri për sa u përket trajnimeve është edhe ai i mësuesve ndihmës. Shumë pak mësues ndihmës kanë përfunduar, janë arsimuar dhe janë profilizuar në pedagogji speciale. Është e rëndësishme që këto trajnime të jenë më të shpeshta dhe të ofrohen falas.

E fundit, për sa i përket aksesit në arsim, problemi që u evidentua vitin e kaluar, që mund të na paraqitet edhe këtë vit, ishte ai i mësimin *online* dhe numri i nxënësve që ngelën të përjashtuar nga aksesit për shkak të mungesës së mjeteve, mungesës së internetit e të tjera me radhë. Grupet “më të diskriminuara” kanë qenë grupet vulnerable, fëmijët nga familjet e varfra dhe në vështirësi ekonomike, si dhe ata me aftësi të kufizuar. Po të shohim edhe rezultatet e PISA-s të vitit 2018, ato tregojnë se të dhënat midis nxënësve që vijnë nga një status më i lartë socio-ekonomik dhe atyre që janë nga grupet vulnerable kanë një diferencë prej dy vjetëve ndryshim në shkollim.

Për t'iu bashkuar edhe asaj që tha zoti Rekaj, vazhdon të jetë problematik edhe plotësimi me mjetet e nevojshme të laboratorëve, kabinetëve, bibliotekave dhe klasave dixhitale. Është absolutisht e nevojshme dhe e domosdoshme që të rritet buxheti për këtë

sektor, sepse është e pamundur me kurrikulën e re, bazuar në kompetenca, dhe të cilësisë së mësimdhënies që ajo kërkon, të vazhdojë të zhvillohet mësimi në kushtet ku është aktualisht.

Kaq kisha në mënyrë shumë të përmbledhur, por edhe për të mos ju harxhuar kohën juve, meqenëse i keni të shkruara më gjatë në dokumentin që kemi dërguar.

Faleminderit shumë!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zonja Lula!

Fjalën e ka zonja Lindita Nikolla, si relatore e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”.

Lindita Nikolla – Përshëndetje!

Jo për kortezi, por për të gjitha ato çfarë transmetuan përfaqësuesit e sindikatave këtu, do të doja t’i falënderoja, sepse janë një instrument i rëndësishëm në ndihmë të sistemit arsimor, por edhe një sy e vesh dhe mendje dedikuar punës dhe përmirësimit të punës në system; po ashtu, specifikisht, edhe një sy për ne që jemi pjesë e Komisionit të Arsimit.

Unë nuk do të doja t’i merrja me radhë të gjitha komentet e tyre, pasi secili prej jush, edhe unë po ashtu, i kemi studiuar me kujdes, duke i zhveshur shpesh edhe nga nuancat politizuese që janë me tepri, por do të doja të ndalesha në tri momente kryesore, ndoshta duke kërkuar nga kolegët një vëmendje, përtej miratimit të buxhetit, për punën dhe në mbledhjet e mëvonshme të këtij Komisioni.

Është vërtet për t’u vlerësuar dhe për t’u marrë në trajtim nga ky Komision çështja e transportit të mësuesve që u ngrit nga zotërinjtë Rekaç dhe Kaptelli. Të gjithë ne në zonat tona e kemi këtë shqetësim dhe, në fakt, ka një mosrakordancë ndërmjet asaj çfarë kërkon Ministria e Arsimit dhe asaj çfarë aprovon Ministria e Transporteve, që lidhet me tarifën dhe shpeshherë tenderat, edhe aty ku ka buxhet, sepse ndoshta është një numër më i vogël mësuesish apo nxënësish që duhen transportuar, dhe dështojnë për shkak se askush nga operatorët e transportit nuk e merr përsipër me ato tarifa që janë të përcaktuara. Ndaj, në këtë këndvështrim, unë do të doja t’i propozoja Komisionit tonë që të thërrasim në një seancë dëgjimore dhe t’i dedikohemi kësaj çështjeje jo vetëm me Ministrinë e Arsimit, por edhe me Ministrinë e Transportit. Kjo është një çështjeje që duhet t’i shkojmë deri në fund, duke dhënë një përmirësim të kësaj situate dhe, më pas, patjetër dedikim të buxhetit, në momentin që vendosen tarifën e reja për transportin.

Momenti tjetër ku dua të ndalem dhe që doli këtu, ka të bëjë me atë çfarë profesor Kovaçi përshkroi, një sërë problematikash që lidhen me pagat, me orët suplementare, problematika që në fakt, nuk u përcollën nga asnjë prej rektorëve që ne kishim në dëgjesat tona, por kjo nuk do të thotë asgjë, sepse rektorët ishin të fokusuar te zërat e buxhetit.

Edhe këtu duhet të ndalemi me kujdes, sepse ligji i ri i arsimit të lartë ua lejon këtë kompetencë universiteteve dhe këtu ndoshta ka vende për të diskutuar se çfarë bëjnë universitetet, në fakt me ofertën e tyre akademike, në mënyrë që të rrisin të ardhurat. Gjithsesi, mendoj që edhe për këtë çështje, nëse duhet korrigjuar udhëzimi i Ministrisë së Arsimit, udhëzimet nuk janë të shkruara në gur, kanë mundësi të korrigjohen dhe për këtë mund të kemi një dedikim të punës së Komisionit me bordet e administrimit, që përcaktojnë nivelin e pagave në universitet dhe Ministrinë e Arsimit, se çfarë mund dhe duhet korrigjuar në këtë drejtim, patjetër duke ndikuar edhe ne, që të rritet granti që shkon për pagat në universitet.

Çështja tjetër ku dua të ndalem dhe që u trajtua këtu, është problemi i mësuesve ndihmës, që u tha nga zonja apo zonjushë Dulaj. Duhet të kemi parasysh, po është e nevojshme, kemi ardhur në momentin që duhet ta shikojmë në mënyrë profesionale këtë çështje, por duhet thënë që mësuesi ndihmës, që ka qenë një shërbim i munguar në sistemin tonë arsimor, është futur në sistemin tonë arsimor. Ndërkohë, oferta akademike, pra universitetet kishin programe specifike, vetëm Universiteti i Vlorës kishte një program që i dedikohej arsimit special, pedagogji sociale. Tashmë janë disa universitete që ofrojnë këtë formim dhe në dijeninë time sivjet ka qenë grupi i parë i mësuesve me arsim special, të cilët janë futur në portalin “Mësues për Shqipërinë”, që do të bëjnë të mundur atë kërkesë prej 200 mësuesish ndihmës që shtohen falë këtij buxheti. Është absolutisht e rëndësishme që këta mësues të trajnohen jo vetëm për pozicionin e tyre si mësues ndihmës, por për gjithçka tjetër që ndodh në klasë, në kuadër të kurrikulës së re, të orientuar nga kompetencat. Këto janë 3 çështjet kryesore që ne duhet t’i adresojmë, në gjykimin tim, dhe për të cilat, patjetër kërkoj edhe vlerësimin tuaj.

Ndërsa, për sa i takon çështjes që në relacione ne të përcjellim edhe komentet pro apo kundër, edhe kjo vlen për t’u gjykuar, por në gjithë praktikën e punës deri më tani, sa herë kemi votuar ligje, edhe kur votohet pro, nuk jepen arsyet se pse votohen pro, edhe kur votohet kundër; kështu është paraparë që vetëm të citohen votat, si pro dhe kundër, me emrat përkatës. Por ne jemi të hapur, unë jam e hapur, që në vlerësimin tuaj edhe pse komentet tona pasqyrohen në procesverbalet e mbledhjeve, edhe pse ne kemi mundësinë që në seancat parlamentare të bëjmë sqarimin e votës tonë, mund të shënojmë edhe në relacion apo në raportin e kësaj mbledhjeje.

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zonja Nikolla!

Atëherë, kalojmë në pyetje dhe diskutime nga deputetët.

Fjala për ju, zoti Piciri.

Erion Piciri – Faleminderit, zoti kryetar!

Janë shumë gjëra për t'u diskutuar dhe nuk e di a kemi kohën e nevojshme. Unë kam një pasion të jashtëzakonshëm për sindikatat, për unionet, siç thonë amerikanët, sepse aty është zemra e kundërshtive dhe e mbrojtjes të njerëzve të thjeshtë, që punojnë në sistem, që janë punonjës, janë mësues edhe kështu me radhë.

Dua të citoj zotin Kovaçi, me të gjithë problematikat e tij, me 8 mijë lekë që i jep pedagogut i jep sa për dy byreqe dhe një gotë dhallë, dhe si mundet ky njeri të marrë dhe rigjenerojë dijet e tij, edhe t'ua kthejë në një mënyrë të vazhdueshme studentëve shqiptarë?! E ndjej realisht vetë një diçka të tillë, që për të arritur një trajnim të mirë 5, 7, 10-ditor në Universitetin e Harvardit të duhen nga 8 deri në 20 mijë dollarë. Kështu që, duke iu kthyer pak buxhetit të shtetit, buxheti për arsimin nuk është 4,51%, por është 2,5 plus shkollat profesionale, shkon diku te 2,7%, që është niveli më i ulët i GDP-së në të gjithë Europën, përfshirë Ballkanin dhe çfarë të dëshirojmë ne, në një moment që GDP-ja shqiptare për frymë është nga më të ulëtat e Europës.

Kështu që, kërkesa është ngutshme, që ne të investojmë fuqishëm në mendjen e pedagogëve dhe të mësuesve shqiptarë, me trajnime falas, nga profesorë vendas dhe të huaj, mos jenë një element fiktiv, por realisht të investojmë, siç duhet, se përmes tyre ne investojmë tek e ardhmja e kombit tonë. Kjo në një financim kronik, thuhet në një moment të caktuar, bëhet një lojë me dy dimensione, me idenë që është në një vit elektoral, do të shtohen pagesat e mësuesve të shkollave parauniversitare, sikurse disa investime që bëhen për rindërtimin. Ato që janë të rindërtimit, nuk lidhen me buxhetin, me prodhimin e brendshëm bruto, janë borxhe që janë në mënyrë periodike vetëm për të rindërtuar shkollat që janë shkatërruar, me fjalë të tjera, nuk kthehen në një vlerë të shtuar në arsimin shqiptar. Ne ende nuk e kalojmë 3%-shin e GDP-së, në mënyrë që ta kthejmë arsimin në një prioritet kombëtar.

Unë kam disa koncepte që lidhen, politikani lidhet me fëmijërinë, me të gjithë të shkuarën e tij dhe unë e kam pasur babanë një sindikalist, të themi, jam fëmijë punëtorësh dhe e vetmja gjë që në qoftë se ne mendojmë të zhvillojmë të ardhëm e këtij kombi, t'u japim një mundësi njerëzve të varfër dhe shtresës së mesme, është arsimi cilësor, por sikurse e kam përmendur këtu, si në shkollat e mesme, si në ato të larta, ne jemi nga arsimi më i ulët, prindi shqiptar investon gjithë jetën e tij, që të investojë siç duhet dhe ta çojë fëmijën të marrë një diplomë dhe njohuri të arta. Ne u japim bakër, të mos themi qymyr, me atë diplomë që u japim, me njohuritë dhe me financimin që i bëjmë arsimit shqiptar, për të cilin duhet një vëmendje komplet tjetër.

Dje diskutoja me një njeri, që realisht ka bërë diçka të veçantë për arsimin shqiptar, duke krijuar një shkollë private të niveleve nga 3 deri në 18 vjeç dhe ajo çfarë vura re, është

një diçka e tillë, që këta investojnë miliona dhe miliona dhe tek arsimi do të duhet kohë për të kuptuar zhvillimin e fëmijëve të tu. Politikanët investojnë në rrugë, në atë rrugën e askundit dhe shumë rrugë të tjera, por jo në arsimin Shqiptar. Por nga pikëpamja vizionare, në qoftë se ne duhet t'i kthehemi botës me një forcë të jashtëzakonshme, janë modelet e Izraelit dhe vendeve të tjera që investojnë në arsim, investojnë në kërkim, investojnë në inovacion; këto janë autostradat e reja të cilat na lidhin me botën moderne.

35 nga 40 mijë, nga më të mirët studentë të këtyre viteve, kanë ikur nga Shqipëria, 93% e tyre, sipas informacionit amerikan, nuk kthehen në Shqipëri dhe kjo është drama më e madhe. Në qoftë se shqiptari ka jetuar në perandori, tendenca është për të ikur nga Shqipëria, nga provinca dhe për të jetuar një herë në Stamboll, edhe nga Brukseli drejt Nju Jorkut, kjo është dëshira më e mirë, sepse ne kemi një koncept global, kështu që në qoftë se duam të ndërtojmë një arsim cilësor, ne duhet të ndërtojmë arsimin për shqiptarin global të së nesërme dhe duhet ta ngremë në nivelet më të larta.

Universitetet deri në nivelin e 6 mijë dhe deri në 20 mijë euro, nuk quhen universitete, nuk di se çfarë quhen, prandaj investimi në arsimin shqiptar është një element bazik. Unë dua shumë që kjo qeveri, por edhe qeveritë që vijnë, të investojnë fuqishëm në arsimin shqiptar. Jemi një racë e veçantë, një racë luftëtarësh, që, në qoftë se arsimohen siç duhet në Shqipëri, kanë mundësi të lidhin me botën e kërkimit të informacionit në mbarë botën dhe kjo është esenca e asaj që ne duhet të bëjmë.

Ky lloj buxheti nuk është buxheti i zhvillimit, jo vetëm me këtë qeveri, por në të gjithë qeveritë në këto 20-25 vjet, është poshtë 3%-shit, me gjithë sistemin privat shkon pak më shumë se 3%, por nuk arrijnë në nivelin më të mirë, në një moment që diferencat më të mëdha mes PBB-së që kemi ne për frymë dhe vendeve të tjera, janë shumë larg. Vendet ballkanike kanë 180 vjet që kanë krijuar universitete, kurse ne i kemi krijuar shumë më vonë.

Kjo qeveri është në ikje dhe bën lëvizjet e fundit, por arsimi shqiptar është esenca me të cilën ne mund të ndërtojmë kombin e së ardhmes. Kjo nuk është politikë, është vizion, ky është transformimi i kombit tonë. Investo te mendja e njeriut, sepse kjo mendje mund të lidhet me mbarë botën, kjo mendje mund të kthehet në investime, kjo mund të kthehet në një pasuri intelektuale, e cila mund t'i flasë botës dhe mund ta bëjë botën disi më ndryshe.

Arsimi nuk është aty ku duhet, është vijimësi e statukuosë që ka nisur me demokratët dhe vazhdon me socialistët. Po, nuk është, e nënvizoj, ajo që mund të ndërtojmë: mendjen e mësuesit, mendjen e pedagogut shqiptar, mendjen e studentit shqiptar. Jemi jashtëzakonisht shumë larg asaj që duhet të ndërtojmë në këtë botë dhe mënyrën se si duhet t'i qasemi kësaj

bote. Model është Izraeli, mendje brilante, por te mendjet brilante pa një kultivim brilant, pa një ekselencë në investimet në arsim, nuk mund të arrijmë dot kurrë.

Politikat janë të mira për të marrë vota, për të bërë disa fasada qytetesh, për të shtruar ndonjë rrugë, por kur flasim për arsimin është investimi i një jete.

Unë e kam pasur babain sindikalist dhe nëna ishte një grua e deklasuar, por që nga fillimi i jetës sime deri tani ata thonë “shkolla, shkolla dhe vetëm shkolla” dhe jam diplomuar 12 herë, nuk e kam ndalur dhe shpresoj, shpejt, pas politikës, këta 6 muaj, të vazhdoj me investime të tjera në çështjen e arsimit. Nuk ndalet arsimi dhe dija. Vetëm përmes arsimit dhe dijës ti je një njeri që respekton veten, frymëzon familjen, frymëzon kombin, i jep një drejtim të asaj që duhet të jemi në këtë botë.

Shqiptarët kanë qenë luftëtarë, shqiptarët janë njerëzit që e admirojnë dijen. Sa investojnë familjet shqiptare në Arsim, nuk investon shteti shqipar dhe kjo është në bazë të studimeve dhe ky dallim i madh duhet të kthehet në politika shtetërore.

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Piciri!

Urdhëroni, zoti Beqiraj!

Ismet Beqiraj – Gjithë çka u tha është tepër konstruktive, pavarësisht ndonjë ngjyrosjeje opozitarizmi tek-tuk, por gjithnjë sindikata është opozitare me qeverisjen.

Nga ana tjetër, nuk kam dashur të vetëprezantohem dhe falenderoj profesor Kovaçin që tha se unë kam qenë në kryesinë e sindikatës së punonjësve të arsimit të lartë. Kjo është e vërtetë, por nga ana tjetër, sa herë që është diskutuar projektbuxheti, gjithnjë jam mundur të mos e përdor këtë kontribut shoqëror në këtë organizim, por si gjithë kolegët e tjerë ta mbështes universitetin.

Qysh në fillim të fjalës sime, falenderoj relatoren!

Ky buxhet është tepër shpresëmadh, sidomos për institucionet e arsimit të lartë, ta themi shqip, edhe pse jemi në kushte të vështira nga dy goditje të rënda. Kur shikoj se janë planifikuar investime të tilla, që ka qenë ëndërr për gjithë botën akademike dhe universitare, kampusi universitar, kampusi i Universitetit të Arteve, kampusi i Akademisë të Policisë dhe investime të tjera, që kanë të bëjnë me Paktin e Universitetit, unë edhe më parë, edhe tani them se nuk mund të ketë universitet pa dy komponentë: profesoratin dhe punonjësit ndihmës të tyre, nga njëra anë, dhe studentët, nga ana tjetër.

Unë mendoj se ka ardhur koha, se një fjalë e urtë thotë: “I fundit o qesh, o qan”, por shpresat janë shumë të mëdha dhe mundësitë janë shumë të mëdha që bota akademike të jetë më së fundi, pozitivisht, sepse i ka ardhur radha.

Pakti për Universitetin, për një arsimim më të mirë, për cilësi, për vlerë të diplomave që nxjerr, nuk mund të bëhet pa trajtimin në mënyrë delikate dhe të merituar të të gjithë trupës akademike. Duke përdorur terminologjinë profesionale, do të thosha se ky pakt “do të ngelë në klasë”, nëse nuk e trajton botën akademike.

Vëmendja e qeverisë është e shtuar në fushën e investimeve kapitale, paketave sociale për studentet në nevojë dhe ekselent, etj., si dhe me trend rritje buxheti për shkencën dhe kërkimin, por me keqardhje, zëri i buxhetit për pagat dhe sigurimet shoqërore mbetet po ai i nivelit të pagave të rritura në fillim të vitit 2017. Pagat e personelit akademik në universitetet publike të vendit tonë mbeten më të ulta se ato edhe në Kosovë. Profesor Skënder Kovaçi, në fjalën e tij, me të drejtë më përmendi disa herë edhe për një angazhim si përfaqësues i punonjësve të arsimit të lartë, gjatë periudhës që kam qenë pedagog me kohë të plotë, para fillimit të këtij mandati, gjë të cilën nuk kam dashur ta përdor në këtë komision. Ndaj i mbështes fuqishëm të gjitha kërkesat për rritje të pagave për personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ në nivele të merituar krahasuar me vendet e rajonit, për rritjen e pagesës së orëve suplementare, jo vetëm për pedagogët e brendshëm, por edhe për pedagogët e jashtëm dhe pedagogët e ftuar, për rivlerësimin e orëve mësimore, ku padrejtësisht ka rreth 2 vjet që është barazuar me vlerësimin 1 (një) si leksioni, seminari, laboratorit dhe praktikat mësimore; gjithashtu orët suplementare të mos konsiderohen si pagë dhe të taten me 23%, por të ribëhet si ka qenë më parë, si honorar dhe të taten në burim me 15%.

Ramazan Gjuzi – Nuk dëgjoheni, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj - Në disa universitete publike dhe sidomos në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe at[Politeknik, në laboratorët, praktikat profesionale dhe kërkimi shkencor zhvillohen në kushte rrisht të lartë me ndotje ambientale toksike, koncerogjene, radioaktive dhe mikrobiologjike ambiental, shumë të dëmshëm për shëndetin.

Disa qeveri, qysh herët, edhe para vitit '90, për këto vende pune kanë parashikuar “dëmshmerinë në punë” për personelin akademik dhe personelin ndihmësmësimor, me akte ligjore dhe nënligjore, si para viteve '90-të dhe pas viteve '90-të, deri në vitin 2008. Po në këtë vit me VKM, qeveria e asaj kohe, “Berisha”, në mënyrë të njëanshme, seleksionuese dhe diskriminuese, krahasuar me institute dhe institucione të tjera, që vazhdojnë të marrin “dëmshmerinë në punë”, e hoqi për të gjitha universitetet publike, vetëm për personelin akademik dhe personelin ndihmësakademik me kualifikim të lartë, kurse personeli ndihmësakademik me arsim të mesëm, vazhdojnë të përfitojnë dëmshmerinë në punë. Ku VKM-ja absurde e Berishës, për të njëjtat vende pune, ku punojnë së bashku pedagogu dhe

personeli ndihmësmësitor me arsim të mesëm, ky i fundit përfiton, kurse pedagogu dhe personeli ndihmësakademik me arsim të lartë, jo!

I kërkoj ministres së arsimit të ketë vullnetin për ta korrigjuar këtë akt nënligjor, sa absurd, aq dhe diskriminues për personelin akademik dhe personelin ndihmësakademik në universitetet publike.

Ramazan Gjuzi – Ju lutem, zoti Beqiraj!

Ismet Beqiraj - Më lini të flas, pasi e latë zotin Piciri teksa bënte teori, ndërsa mua nuk po më lini.

Për rivendosjen e shtesës për page, nuk duhet të rivendoset, sepse ka të bëjë me lëndë radioaktive, ka të bëjë me hidrokarbure, ka të bëjë me viruse, sepse ka laboratorë dhe qendra të kërkimit shkencor që sot i marrin, kështu që universitetet nuk duhet të diskriminohen për këtë trajtim.

Unë kam luftuar fort, le të thotë kush të dojë që unë sot po flas si sindikalist, por kjo është një e drejtë që duhet kthyer, sepse është një absurd. Në VKM-në që ka bërë ish-kryeministri Berisha, i ka hequr pedagogut dhe punonjësit ndihmës me arsim të lartë koeficientin e vështirësisë dhe ia ka lënë punonjësit ndihmës me arsim të mesëm dhe ky është një non sens.

I mbështes të gjitha propozimet që bëri relatorja, sidomos për trajtimin në universitet, si dhe të gjitha sugjerimet që bëri profesor Kollovaçi, prandaj mendoj se ne duhet të bëjmë një dëgjesë me ministren e Arsimit, me bordin, si dhe me rektorët, po të jetë e nevojshme.

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Po, zoti Çela.

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Çela!

(Mungesë incizimi.)

Nuk dëgjohet.

Po, zoti Piciri, shkurtimisht.

Erion Piciri – Faleminderit!

Meqë m'u përmend emri, si dhe lashë edhe diçka pa qartësuar, kisha diçka për atë që tha një zonjë në lidhje me cilësinë e arsimit, dua ta plotësoj.

Ka një studim të Universitetit të Prestonit, në bazë të të cilit në qoftë se njeriu e provon varfërinë në moshën 6 deri në 12 vjeç, nuk ka shans për sukses në jetë. Ndoshta qeveria shqiptare, jo kjo e sotshmja, por një qeveri e ardhshme, duhet të krijojë kushte optimale që këta nxënës të vegjël të kenë shans për sukses në jetë.

Sa i takon këtij fakti, duhet një vëmendje e madhe, pasi vendi ynë në pjesën më të madhe të tij jeton në varfëri të madhe, rreth gati 40%, ndërsa shtresa e mesme nuk ka arritur ende të konsolidohet në nivelet më të larta. Kështu që edhe arsimit duhet siguruar jo vetëm nga pikëpamja e mësimdhënies, por edhe nga mundësitë reale, sepse talenti, siç thoshin një herë e një kohë amerikanët, nuk është se lind e zhvillohet tek të pasurit e këtij vendi, të cilët realisht shkojnë në shkolla më të mira, por te çdo njeri. Këtu qëndron ajo e majta e vërtetë dhe moderne që mungon në Shqipëri për të investuar arsimin, për të parë kushtet e studimit të shtresave rurale, varfërinë nëpër qytete dhe për t'u dhënë këtyre fëmijëve një mundësi për arsim cilësor dhe për një sukses në jetë.

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Piciri!

Po, zoti Papa.

Zoti Papa, nuk dëgjoheni.

Kostaq Papa – A dëgjohem tani?

Ramazan Gjuzi – Po.

Ju lutem, shkurtimisht!

Mirela Kumbaro – E dua edhe unë fjalën më pas.

Ramazan Gjuzi – Patjetër.

Kostaq Papa – Kam diçka në lidhje me buxhetin e vitit 2021 për arsimin, duke u përafëruar rreth tij. Duke përshëndetur përfaqësuesit e sindikatave, na duhet ta pranojmë se ata kanë një përjasje reale me situatën dhe gjendjen në terren të arsimit shqiptar, por ne si komision duhet të japim mesazhe politike, të cilat kanë të bëjnë me përpjekjet që bëjmë në lidhje me ruajtjen dhe mbrojtjen e arsimit, sidomos atij parauniversitar, duke parë edhe situatën pandemike në të cilën ndodhemi, si dhe mungesën së një sërë shkollash si rezultat i tërmetit në Shqipërinë e Mesme.

Ne duhet ta shohim buxhetin për arsim, sidomos duke u nisur nga gjendja reale dhe ta mbështesim e ta mbrojmë. Pra, ne duhet ta mbrojmë sistemin parauniversitar dhe nuk do të lejojmë që të rrëshqasë, qoftë edhe me zgjerim apo me shtim të numrit të arsimtarëve apo të nxënësve, si numër pandemik.

Gjatë diskutimit të buxhetit të vitit 2021, duhet të prekim ato probleme që thanë përfaqësuesit sindikalistë, pra ato probleme që kanë të bëjnë me buxhetin për transportin. Po ashtu, do të shtyhesha edhe pak më tej, ku gjatë 7-8 vjetëve të fundit në arsim është bërë një çorbë në lidhje me diplomat dhe kjo gjë duhet parë më mirë. Pra, duke u nisur nga problemet në arsim, ashtu siç do të shohim transportin, duhet të shohim edhe klasifikimin real të

diplomave dhe se çfarë ka ndodhur, kjo si rezultat i militantizmit 7-8 vjetët e fundit, qoftë edhe në kohën e PD-së, por më shumë të PS-së.

Shumë arsimtarë i janë afruar partisë për të kaluar nga arsimtarë të ciklit 9-vjeçar në arsimtarë të gjimnazeve. Çfarë është bërë? Ata kanë zaptuar akademitë e qyteteve tona, po i quaj në këtë mënyrë gjimnazet e rretheve, në mënyrë militanteske, duke bllokuar zhvillimin dhe konkurrencën arsimore të arsimtarëve...

Ramazan Gjuzi – Zoti Papa, mbylleni fjalën.

Kostaq Papa – Po e mbyll, zoti kryetar.

Ne duhet ta shohim me kujdes buxhetin e vitit 2021 dhe se çfarë mundësish reale ka ky buxhet për të përmirësuar rritjen e rrogës së arsimtarëve në kushte më reale. Përqindja që tha Kryeministri, po ta shohësh me tregues realë, nuk është një përqindje e dukshme, siç është për bluzat e bardha, të cilët për momentin kanë shumë rëndësi, duke qenë heronjtë tanë, por arsimtarët janë baza e ruajtjes dhe e mbrojtjes së zhvillimit dhe prosperitetit të shtetit dhe të atdheut.

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Papa!

Kostaq Papa – Faleminderit, zoti kryetar!

Ramazan Gjuzi - Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Faleminderit, për fjalën!

Sinqerisht, po marrim shumë kohë, të dashur kolegë, duke bërë teori, ndërkohë që kemi shifra konkrete. Nuk po flas për faktin, siç e thanë me të drejtë edhe kolegët e sindikatave, se një pjesë e mirë jona nuk vijnë nga 30 vjet politikë, siç mund të jenë disa, por vijnë nga 30 vjet bagazh arsimor dhe eksperiencë të drejtpërdrejtë nga bankat e shkollës dhe nga fusha e arsimit ose duke dhënë mësim, ose duke diplomuar dhe formuar arsimtarët.

Të flasësh kodra pas bregu, nuk po them emra të përveçëm, për politizim të arsimtarëve në këto 7 vjet, është sikur të mos kesh jetuar fare në Shqipëri, si dhe të harrosh revolucionin e madh që është bërë në fushën e arsimit parauniversitar me sistemin e Portalit të Mësuesve për Shqipërinë. Më në fund mbaroi koha ku çdo shtator mësuesit, të gjithë jemi deputetë dhe vijmë nga territore, pra nuk jetojmë në Mars, ku praktikisht jemi çdo ditë në kontakt me arsimtarët, të ishin në dorë të drejtorit të arsimit, kryetarit të partisë së maxhorancës. Këtu nuk po bëj dallime për maxhorancën e majtë apo të djathtë, por për çfarëdolloj maxhorance që kishte pushtetin, ministri e kështu me radhë, apo deputeti i zonës. Kjo kohë ka mbaruar një herë e përgjithmonë, sepse sot, shkoni e pyetini arsimtarët, në qoftë se keni minimumin e vullnetit, për të kuptuar se as nuk e kemi idenë, as deputetët, as kryetari i partisë, madje as drejtori i zyrës arsimore nuk e ka fuqinë të ndërhyjë në portal dhe të kthejë rezultatit e një sistemi, që është

krejtësisht transparent dhe është meritë absolute e vetëm kësaj qeverisjeje, sikurse e bëmë për infermierët, sikurse po e bëjmë tani për drejtorët e shkollave. Ju harroni që të gjitha këto janë pjesë e buxheteve publike, që kjo qeveri i ka vënë në dispozicion të sistemit të arsimit, që në finale, të prodhojnë cilësi në arsim. E para.

E dyta, desha të falënderoj zotin Kaptelli për përpjekjen për të qenë i detajuar!

Më bëri përshtypje një element, që ka të bëjë me shkollat private dhe kërkova në shifra për të qenë sa më e saktë, thjesht për informacion të kolegëve dhe timin gjithashtu. Për sa u përket shkollave private në vitin 2012-2013, po i referohem vitit akademik, kemi pasur 296 shkolla private në arsimin parauniversitar, pa përfshirë këtu kopshtet, ndërsa në vitin 2019-2020 kemi 167 shkolla private, gjithsesi edhe këtu pa përfshirë kopshtet, të cilat normalisht mund të kenë një shtrirje, një ofertë më të gjerë. Kjo ishte për saktësim.

Ajo që dua të theksoj, gjithashtu, është se do të ishte mirë të jemi konkretë dhe të ndihmojmë, se në finale jemi të gjithë për një qëllim të përbashkët, të mund të rrisim sa më shumë jo thjesht buxhetet, rrogat si zarfe, por në shërbim të një arsimit cilësor.

Kur flasim për rritje të sistemit të dixhitalizimit apo për të gjithë sistemin e portaleve, dhe më lejoni t'i heq kapelën koleges, që është edhe relatorja e këtij buxheti, zonjës Nikolla, që në fakt janë ato gjërat, që fjalët i merr era, por puna e portalit ka për të mbetur në vite, edhe kur ne të mos jemi fare në këtë tryezë. Të paktën t'i themi gjërat siç janë, asgjë nuk është perfekt, por të gjitha këto, shtu këtu edhe vullnetin që ne kemi pasur, dhe vullnetin që ka pasur kjo qeverisje për të mbyllur të gjithë kioskat e tmerrshme të universiteteve, dhe këtu tek universitetet, sinqerisht nuk pranoj njeri të më japë mend, sepse e kam pësuar në kurriz, dhe ndoshta bëj pjesë në njerëzit që janë pionierë të sistemit universitar pas viteve '90.

Pra, pastrimi që i është bërë asaj kalbësire të kioskave me xhamllëqe, qelqe, vitrina e çfarë të doni ju, ishte kjo qeveri që e pati kurajën ta bënte, duke marrë përsipër edhe jo pak kosto sociale, këtë e dinë të gjithë shumë mirë, por siç e pamë në vitin 2017 vetëm u përshëndet nga elektorati dhe nuk u penalizua aspak. Të njëjtën logjikë kemi pasur kudo. Nuk është kollaj që në 7 vjet apo në 1 vit, aq më tepër në 2 vite të rënda, siç ka qenë viti i rindërtimit dhe viti i pandemisë, të mund të pastrojmë dhe të sistemojmë të gjithë hallet dhe kusuret që i kemi bërë në tranzicion sistemit arsimor në 30 vjet. Ka qenë 25 vjet një bombë me efekt të vonuar dhe ju siguroj që as vitin tjetër nuk kemi për ta zgjidhur dot tamam. Do ta vuajmë shumë gjatë problemin e cilësisë në arsim, problemin e *part-time*, apo problemet që ka pësuar qoftë sistemi parauniversitar, edhe ai universitar.

Kështu që, në qoftë se duam të jemi realistë, le të flasim konkretisht për këtë buxhet, jo thjesht të rrisim rrogat, por i gjithë fondi që i është kushtuar rindërtimit të shkollave të dëmtuara, sigurisht që është një investim shumë i rëndësishëm.

Unë bashkohem me shqetësimin e transportit. Jam dakord dhe e mbështes iniciativën e zonjës Nikolla, që ta bëjmë këtë seancë sa më shpejt të jetë e mundur, të ndërmarrim një seancë me përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Transportit, kryetar, se edhe unë e ndiej këtë problem në zonën që përfaqësoj, lidhur me mospërputhjen ose mosrakovimin midis dy institucioneve, të cilat në finale duhet të shikojnë një interes të përbashkët, që është ai i cilësisë në arsim, se edhe kjo aty transferohet.

Kështu që ftoj kolegët që ta kursejmë këtë pjesë të kohës, (ndjesë, se nuk doja të zgjatesha, por disa gjëra duhen thënë siç janë, se flasim e flasim, dhe harrojmë produktet që mbeten dhe që ne sot praktikisht i jetojmë vetë), që të ecim para me axhendën e komisionit dhe të ndjekim sugjerimet e relatores së buxhetit.

Shumë faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zonja Kumbaro!

Zoti Ulqini, fjala për ju.

Musa Ulqini – Kam vetëm një koment të shkurtër, zoti kryetar.

Faleminderit që ma dhe fjalën!

I kam dëgjuar gjithmonë me respekt përfaqësuesit e sindikalistëve në komisionin tonë dhe dua të them se kam shumë respekt për punën e tyre, siç e tha edhe zonja Lindita, por unë mendoj se nuk rriten kreditet e drejtuesve të sindikatave në raport me anëtarët e tyre, duke aplikuar sistemin e një kritike, që është përtej mundësive reale të shoqërisë apo të shtetit në një situatë të caktuar.

Nëse sot me të vërtetë në Shqipëri nuk ka sindikalizëm të vërtetë, kjo është për dy arsye, në gjykimin tim: për shkak se një pjesë janë tejet të politizuara dhe një pjesë tjetër kërkojnë gjëra, që nuk kanë lidhje me realitetin. Unë mendoj se sensi i masës është rregull i artë, që vlen shumë edhe në raport me sindikatën dhe drejtuesit e saj.

Ky rregull i bën shumë të pranueshme sindikatat edhe për qeveritë, por edhe për ata që përfaqësojnë. E kam shumë dashamirëse këtë gjë, gjithmonë duhet kërkuar duke pasur parasysh sensin e masës, si një rregull i artë në aktivitetin e sindikatave. Kështu ndodh kudo në botë.

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Faleminderit, zoti Ulqini!

Po, zoti Piciri.

Erion Piciri – Do t'ia lë fjalën sindikalistit, se ai është zemra e sistemit mësimor...

Ramazan Gjuzi – Po, zoti Kaptelli, fjala për ju.

Novruz Kaptelli – Unë e dëgjova edhe zonjën Kumbaro, edhe zotin Ulqini. Për t'ju sqaruar, nuk ju kundërshtoj për shifrat që thatë lidhur me shkollat, zonja Kumbaro, sepse nuk e di sa ka qenë numri i shkollave atëherë dhe sa është tani. Unë këtu përcolla një shqetësim, që na vjen nga drejtuesit tanë sindikalistë.

Sa është e vërtetë ajo që thashë unë. Unë do të sqaroja se në Shqipëri vitet e fundit numri i nxënësve në arsimin parauniversitar ka rënë në mënyrë drastike, kjo për arsye të planifikimit familjar, rënies së numrit të lindjeve, për arsye të emigracionit të lartë, për arsye të tërheqjes në arsimin privat, për arsye të braktisjes së shkollës, sidomos nga fëmijët e komuniteteve romë dhe egjiptianë, dhe të gjitha këto së bashku kanë çuar në një shifër, që le ta verifikojë zonja Kumbaro dhe kushdo tjetër, në rrethin e Korçës nga 6 mijë nxënës, që duhet të regjistroheshin në klasën e parë këtë vit shkollor, janë regjistruar vetëm 2 mijë e 100 nxënës. Kjo do të thotë se janë regjistruar vetëm 1/3 e nxënësve që regjistrohen sot në klasën e parë. Ky informacion është marrë nga zyrat e gjendjes civile, sipas burimeve të Ministrisë së Brendshme, pra duhet të ishin regjistruar 6 mijë nxënës, por një pjesë e madhe e tyre janë në Greqi, në Itali, në Amerikë, në Angli edhe në shtetet e tjera të botës, një pjesë janë në shkollat private dhe kjo që mbetet është vetëm 1/3-ta. Kështu që, shqetësimi që ngre unë nuk ka të bëjë me numrin e shkollave, sepse numri i nxënësve ka rënë shumë që nga viti 2012 në vitin 2020. Unë po them që në proporcion me atë që ka qenë, numri i nxënësve që ka kaluar në arsimin privat është numër shumë më i madh.

Në përgjigje të asaj që tha zoti Ulqini, që ne i shohim gjërat politikisht, ne nuk i shohim gjërat politikisht, se po të ishte për politikë, zoti Ulqini, të vinte atëherë kur diskutohej në Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, ku të gjithë, edhe përfaqësuesit e ministrive, janë në unison me këto që ngremë ne. Ju nuk e dini si është katandisur regjistri i shkollës sot, sepse një pjesë juaja është shkëputur nga arsimit dhe nuk e dini që mësuesit tanë trajtohen me një pagë shumë më të ulët se ato të Maqedonisë. Unë do të kisha kërkuar këtu, ashtu siç kam kërkuar më parë, që mësuesit shqiptarë, të paktën, të trajtohen sa gjysma e atyre që janë në Maqedoni. Maqedonia është një shtet fare i vogël, që i ka trajnuar të gjithë mësuesit me përdorimin e teknologjisë bashkëkohore dhe i ka pajisur të gjithë mësuesit me *lap top*, është një shtet që i ka...

Mirela Kumbaro – Zoti kryetar, për procedurë kërkoj fjalën.

Novruz Kaptelli - Nuk ka procedurë këtu. Të mbaroj unë, pastaj ndërhyjni për procedurë.

Mirela Kumbaro - Zoti Kaptelli, nuk e drejtoni mbledhjen ju.

Ramazan Gjuzi - Zoti Kaptelli, kohën e kemi të kufizuar, ju lutem, shkurtimisht!

Po, zoti Ulqini.

Musa Ulqini - Unë do të them vetëm pak fjali. Nuk përmenda asnjë njeri me emër, por e thashë si dukuri. E falënderoj nga zemra zotin Kaptelli, që më dha mundësinë që ta çoj deri në fund. Nëse ka një simbol të politizimit ekstrem të pozicionit dhe rolit të sindikalistit, modeli më i keq në Shqipëri, e kam ndjekur prej disa vitesh, është vetë zoti Kaptelli. Nuk desha ta thosha, por e falënderoj zotin Kaptelli, që më krijoi mundësi të them një gjë të tillë. Pra, është modeli më i keq i politizimit të pozicionit të sindikalistit, duke bërë që sindikatat të duken shtojcë të partive politike dhe duke dëmtuar në thelb sindikalizmin.

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi – Po, zoti Piciri.

Erion Piciri - Vetëm 4-5 fjali në kuadrin e asaj që u diskutua. Nuk ka revolucion, zonja Kumbaro, pa financim, sepse financimi është elementi më bazik. Nëse financimin e kemi 2,5-2,7 %, kurrë nuk mund të kemi zhvillim në arsim.

Elementi i dytë është cilësia e shkollave, cilësia në shkollat private dhe publike. Ajo që përmendi zori Nevruz Kaptelli është një fenomen që shtrihet në mbarë shoqërinë, nuk lidhet me një parti dhe me një tjetër, lidhet me një koncept historik. Ne kemi jetuar në perandori, njerëzit ikin nga provincat drejt qendrave të mëdha. Kjo është një nga frikërat më të mëdha, u boshatisën fshatrat dhe qytetet e vogla, pastaj e gjithë Shqipëria. Që të mos boshatiset investimi në arsim, mendja në këtë vend, ka mundësi të na kthejë në një pol. Nga pikëpamja e sigurisë krijimi i Tiranës si një pol i rëndësishëm arsimor, ekonomik dhe i elementeve të tjera, mund të bëjë në një moment të caktuar që të ndalojë emigracionin e familjeve dhe të rinisë shqiptare, që të fillojmë të ndërtojmë diçka për këtë vend. Nëse vazhdon ky lloj trendi, që nuk ka lidhje me socialistët, por është një trend i përgjithshëm i këtyre 30 vjetëve, do të boshatiset Shqipëria. Një nga elementet e rëndësishme lidhet me cilësinë e arsimit. Nuk jemi në cilësinë më të mirë arsimore.

Zonja Kumbaro foli për kioska, por po ju them se Universiteti i Tiranës renditet në vendin e 6500, pra është një lloj kioske disi më e madhe, por i kemi vënë emrin publike dhe e kemi nderin e Shqipërisë. Po të rendit në vendin e 6500-të nga 25 mijë, nuk janë universitete këto, zonja Kumbaro. Edhe ne të gjithë jemi në bankat e shkollës, 40 vjet kam unë që jam në bankat e shkollës, por duhet ta shikojmë më ndryshe dhe në luftë të përhershme me partitë politike, që t'i japim arsimit më shumë financime dhe ta shohim me prioritet.

Ramazan Gjuzi – Po, zoti Rekaj.

Isa Rekaj - Ne nuk donim t'i shtronim kërkesat politikisht, ne u nisëm vetëm nga politikat arsimore. Ato, nëse i patë me kujdes, janë minimale. E kemi parasysh situatën e tërmetit dhe të pandemisë. Ministria e Arsimit është në dijeni se, që nga momenti i tërmetit tragjik të datës 26 nëntor dhe pandemisë, ne nuk kemi kërkuar rritje pagash, por problemet minimale që i duhen arsimit, qoftë për pajisjet me mjetet e nevojshme, sepse kërkohej që mësuesit të jepnin mësim në distancë, ose për nxënësit që u përkasin shtresave të varfra. Rritjen e pagave ne e përsëritëm dhe e mirëpresim, por ne nuk kishim kërkesë për rritje pagash. Ne e dimë sa duhet të jetë paga e një mësuesi për të bërë arsim cilësor, por për kushtet e sotme të pandemisë dhe pasojat e rënda të tërmetit, ne po kërkojmë ndihma nga të tjerët, rritje pagash nuk kemi kërkuar. Pra, ne e dimë çfarë kërkojmë, kur duhet, por edhe kur ta kërkojmë. E them edhe një herë, ne nuk nisemi politikisht, por nga politikat arsimore që i nevojiten arsimit.

Faleminderit!

Ramazan Gjuzi - Faleminderit!

Zoti Kovaçi, shkurtimisht, sepse e kemi të limituar kohën.

Sandër Kovaçi – E di, më falni, por, duke respektuar zotin Ulqini në lidhje me vërejtjen e tij, në përgjithësi sindikatat janë në mënyrë figurative një forcë politike. Ata përfaqësojnë ato grupe shoqërore, të cilat nuk përfaqësohen nga partitë politike ose nga qeverisja. Për ne në përgjithësi kërkesat e sindikatës konsiderohen si një politizim si majtas, aashtu edhe djathtas. Edhe kur marrin kërkesat e sindikatës vënë duart në kokë dhe thonë na mërzhitën këta. Kështu që, zoti Ulqini të mos e shohë si politizim, por ta shohë në mënyrë që të ecim përpara, ta shikojë si një ndihmë, si një kontribut, si një vështrim ndryshe të problematikave. Po u mbledhëm dhe ta diskutojmë në këtë frymë, do të zgjidhim edhe problemet, edhe nuk do të kemi më këto shqetësimet e politizimit ose të kuptimit sikur është politizim. Pra, ta shikojmë si një vështrim real të çështjes.

Ramaz Gjuzi – Zoti Ulqini, nuk kemi kohë, sepse na pret komisioni tjetër.

Po, hapeni mikrofonin.

Musa Ulqini – Zoti Kovaçi, kam shumë respekt për ju dhe për parafolësin dhe jeni një vlerë e kësaj shoqërie, por unë distancohem nga diskutimet e llojit që u thanë pak më sipër nga zoti Kaptelli. Një diskutim si i zotit Kaptelli, e dëmton sindikalizmin, ndërsa diskutime si juaji dhe i zotit Reka e ndihmojnë edhe parlamentin, edhe shoqërinë, edhe sindikalizmin.

Ramazan Gjuzi -Faleminderit, zoti Ulqini!

Kush është dakord me propozimet që bëri relatorja për tri çështjet që ngriti: të ftojme Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Transportit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Të nderuar drejtues të sindikatave dhe të Qendrës për Arsim, ju falënderojmë për pjesëmarrjen! Shqetësimet tuaja do t'i përcjellim në takimin me ministret e Arsimit, të Financave dhe të Transportit.

Ditë të mbarë!

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.11.2020, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ramazan Gjuzi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

2. Diskutimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”.

Marrin pjesë:

Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Bujar Çela, Fatjona Dhimitri, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Erion Piciri, Amra Barova, Selami Jenishehri.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Të ftuar:

Gentian Opre – drejtor i Analizës dhe i Programimit Buxhetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Ramazan Gjuzi – Atëherë, fillojmë pikën e dytë të rendit të ditës: diskutimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2021”.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 22. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Atëherë, e votojmë projektligjin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”? Kundër? 2 vota kundër, zoti Piciri dhe zonja Dhimitri. Abstenim? Nuk ka.

Miratohen në tërësi buxheti i vitit 2021.

Zonja Kumbaro, në lidhje me kalendarin e takimeve që do të bënim nëpër rrethe.

Mirela Kumbaro – Unë mendoj që të mirëpresim propozimin e parë që kemi për Beratin në koordinim edhe me zotin Nasufi. Unë, në fakt, meqenëse jemi edhe pjesa më e madhe e kolegëve në linjë, do të doja të binim dakord se cila ditë mund të jetë më e përshtatshme për ta bërë këtë, ndoshta në fillim të javës tjetër.

Erion Piciri – Javën tjetër më duket se ka seancë plenare, apo jo?

Mirela Kumbaro – Të hënën?

Ramazan Gjuzi – Po, të hënën ka seancë.

Mirela Kumbaro – Në datën 16 paska seancë plenare?! Nuk e dija.

Fadil Nasufi – Po në datën 16 dhe 19 ka seancë plenare.

Ramazan Gjuzi – Zonja Kumbaro, në qoftë se doni, mund ta organizoni në bashkëpunim me OSBE-në, por duhet të komunikoni me ta.

Mirela Kumbaro – Dakord në këtë version duhet komunikuar sot me OSBE-në.

Ramazan Gjuzi – Dhe atëherë caktohet data.

Mirela Kumbaro – Atëherë, dita e martë, datë 17 nëntor si është për kolegët?

Erion Piciri – Për çfarë është fjala? Çfarë është në rend dite?

Ramazan Gjuzi – Vizitë në qytetin e Beratit...

Fadil Nasufi – Për trashëgiminë, turizmin dhe kulturën materiale të tij.

Ramazan Gjuzi – Po, zoti Ulqini.

Musa Ulqini – Dita e martë është shumë mirë, në qoftë se COVID-i na jep leje.

Ramazan Gjuzi – Edhe unë këtë mendim kisha. Atëherë, e lëmë në parim në datën 17 nëntor.

Musa Ulqini – Gjithmonë, në qoftë se COVID-i na jep leje.

Mirela Kumbaro – Sigurisht, me këtë rezervë.

Ramazan Gjuzi – Po na dha leje COVID-i ,se po nuk na dha ai... Por ai nuk na pyet. Atëherë, a ka ndonjë problem tjetër? Nuk ka.

Për mbledhjen e ardhshme do t’ju njoftojmë. Do të rakordohemi me ministrinë, pastaj do t’ju njoftojmë datën se kur do ta zhvillojmë mbledhjen.

Erion Piciri – Një ditë të mbarë! Mirupafshim!

Mirela Kumbaro – Dakord!

Ramazan Gjuzi – Mirupafshim!

Një ditë të mbarë dhe t’ia kaloni mirë!

MBYLLET MBLEDHJA